

## PËRSHËNDETJA E PARTISË KOMUNISTE TË SPANJËS PARAQITUR NGA SHOKU RAUL MARKO

Të dashur shoqe dhe shokë,

Enver Hoxhës mbas kaq vjetësh i është rritur akoma më shumë reputacioni i tij. Kështu ndodh me figurat që kanë bërë epokë, epokë që tregojnë se njerëzimi ecën përpara dhe nuk ndalet. Hyn në lojë roli i individit në shoqëri. Enver Hoxha është njëri nga ata. Një individ, një komunist që përballoi rrebeshet e epokës në të cilën jetoi dhe kundër së cilës luftoi. Ai, si dhe udhëheqës të tjerë komunistë, u jep kuptim vjershave të Bertold Brehtit mbi rolin e individit çdo ditë e në të gjitha kohërat.

Leninist konsekuent, Enveri luftoi kundër imperializmit amerikan, kundër çdo lloj imperializmi dhe tentativave të tyre për të gjuhëzuar Shqipërinë socialiste. Sot, kur kriza imperialiste po tregon haptazi drejtësinë e analizës markiste dhe veçanërisht, të Leninit mbi imperializmin, si faza e fundit e kapitalizmit, duhet kujtuar mirë atë që bëri Enveri në librin e tij "Imperializmi dhe Revolucioni" që paralajmëronte se për të dalë nga kriza vendet imperialiste krijojnë aleanca dhe marrëveshje për të evituar shembjen e sistemit të tyre. Sot diskutohet më tepër se dje në këtë drejtim. Përfundimi në të cilin arrijnë ekonomistët borgjezë botërorë është privatizimi i përfitimeve dhe shoqërizimi i humbjeve. Kjo do të thotë se punëtorët, fshatarët dhe klasa punëtore, shtresat e borgjezisë së vogël e të mesme, duhet të përballojnë efektet negative të krizës. Për këtë kërkojnë aleanca të reja, përballen me njëri-tjetrin, bashkohen e ndahen, siç e thoshte Enver Hoxha në librin e tij "Imperializmi dhe Revolucioni": "Jeta tregon vazhdimisht tezat gjeniale të Leninit mbi imperializmin. Kapitalizmi ka hyrë në fazën e tij të kalbjes... Lufta e pupujve kundër imperializmit dhe shërbëtorëve kapitalistë borgjezë bëhet në forma të ndryshme, me intenzitet të ndryshëm. Në mënyrë të paevitueshme sasia do shndërrohet në cilësi".

Përballë kësaj situatë ndërkombëtare, në të cilën përgatiten sulme të reja e brutale kundër popujve, komunistët, marksistë-leninistët duhet të bashkohen, të zhdukim dallimet tona, me një trajtim adekuat ideologjik, për të përballuar këtë ofenzivë të kapitalizmit, e mbi të gjitha, që popujti tanë të dinë se nuk ka rrugëdalje tjetër veç luftës së klasave.

Konferenca Ndërkombëtare e Partive dhe Organizatave M-L (CIPOML) e formuar para 15 vjetësh, lindi në luftën kundër revizionizmit dhe oportunitizmit, që fatkeqësisht çoi drejt rënies së shumë partive deri në zhdukjen e tyre. Revizionizmi siç paralajmëroi Enver Hoxha dhe më parë Lenini dhe Stalini, është një kancer që gërryen dhe likuidon detashjentin e pararojës të proletariatit në rast se nuk e zbulojmë dhe luftojmë në kohë. Kjo është një luftë për jetë a vdekje, siç na mëson eksperiencia e hidhur në shumë raste. Mendojmë ashtu siç paralajmëroi Enver Hoxha: "Situata aktuale ndërkombëtare është e turbullt, kriza në vendet kapitaliste dhe revizioniste thellohet, politika agresive e superfuqive pjell çdo ditë rreziqe të reja e të mëdha për lirinë e pavarësinë e popujve dhe paqen në përgjithësi... Mbëshetur në këto kushte mbrojtja e Marksizëm-Leninizmit, e principeve të internacionalizmit proletar, qëndrimi konsekuent dhe



revolucionar ndaj problemeve të mëdha përbën sot për të gjithë marksistë-leninistët autenitkë një detyrë themelore".

Në këtë luftë duhet të marrin pjesë të bashkuar gjithë komunistët, gjithë ata që mendojnë se Marksizëm-Leninizmi është aktual dhe jetësor. Internacionalizmi proletar për të cilin luftuan kaq shumë komunistët shqiptarë nën udhëheqjen e KQ të tyre të kryesuar nga Enver Hoxha, është një flamur që duhet mbajtur gjithnjë lart. Kemi difekte e vështirësi, por duhet të ecim përpara kundër pozicioneve të gabuara, të luftojmë eklettizimin, këtë qëndrim hipokrit që mundohet të bashkojë mekanikisht tendencat e korentet ideologjike heterogjene.

Pak e nga pak po dalim nga shpërbërja e shkaktur nga ofensiva e madhe antikomuniste e imperializmit në vitet 1960 dhe e favorizuar nga qëndrimet antimarksiste të hrushovizmit, trockizmit e të teorisë së tre botëve, eurokomuniste etj. Por nuk mund të kënaqemi me kaq. Jemi akoma larg arritjes së unitetit të madh të komunistëve mbi bazën e principeve të Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit dhe udhëheqësve të mëdhej komunistë si Enver Hoxha, ndryshe nuk do të arrihet uniteti i vërtetë. Kjo është një detyrë madhe që kemi përpara. Nga ana jonë do të vazhdojmë të ecim përpara në këtë rrugë, që nuk është tjetër veçse e internacionalizmit proletar në praktikë dhe jo më fjalë e mitingje boshe.

Nga kjo tribunë në të cilën përkujtojmë Enver Hoxhën, konfirmojmë solidaritetin tonë me komunistët shqiptarë që luftojnë në kushte të vështira kundër gjendjes së rëndë aktuale, për forcimin e konsolidimin e Partisë. Ne që e kemi njohur Shqipërinë që nga viti 1965 kemi parë nga afër përparimet e mëdha të arritura nga viti në vit nën udhëheqjen e PPSH. E themi këtë sepse e kemi parë me sytë tanë me çfarë përkushtimi dhe heroizmi kanë ndërtuar socializmin komunistët dhe populli shqiptar përballë manovrave të titistëve, hrushovianëve, maoistëve dhe përpjekjeve të brendshme e të jashtme për të destabilizuar vendin dhe sukseset e arritura.

Sot, njësoi si dje, jemi bashkë me ju. Na bashkojnë lidhje të vjetra, të bazuara në principe të përbashkëta, në internacionalizmin proletar që Enver Hoxha i mbrojti gjatë gjithë jetës së tij. Jemi të ndërgjegjshëm se detyra juaj nuk është e lehtë, për të përmbysur regjimin reaksionar të mbështetur e përkrahur nga imperializmi amerikan i cili shkatërroi socializmin në Shqipëri duke e kthyer vendin në ditët më të zeza të jetës së vet. Fjalët e shokut Enver në Kongresin e 7-të të PPSH janë prezente në shpirtin tonë e të gjithë komunistëve: "Bota ndodhet në një fazë që kauza e revolucionit dhe e çlirimit kombëtar e popujve nuk është vetëm një aspiratë e perspektivë, por një problem i shtruar për zgjidhje".

Ne jemi të sigurtë se komunistët shqiptarë bashkë me popullin do të ngrejnë lart shpatën simbolike të Skënderbeut dhe do të arrijnë që të valavitet përsëri flamuri i kuq i proletariatit, i revolucionit në malet dhe fushat e vendit të shqiptonjave.

Nder e lavdi shokut Enver Hoxha!

Rroftë miqësia midis partive tonal!

Rroftë Marksizëm-Leninizmi!

Rroftë internacionalizmi proletar!